




## MANDATI

- Institucion gjyqësor i përkohshëm.
- Mandat dhe juridiksion mbi krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të parapara në legjislacionin e Kosovës, siç përcaktohet në nenin 15 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
- Vetëm përgjegjësi penale individuale.
- Krimet e pretenduara janë kryer midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 dhe lidhen me pretendimet që përmban Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës i vitit 2011.
- Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë juridiksion mbi persona fizikë të cilët janë shtetas të Kosovës/ Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), ose mbi persona të akuzuar për kryerje krimesh kundër personave që janë shtetas të Kosovës/RFJ-së.
- Dhomat e Specializuara të Kosovës mundësojnë pjesëmarrjen e viktimave në procedura.

## STRUKTURA



- Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë
- Sipas nevojës, Kryetarja cakton gjykatësit nga regjistri në një çështje gjyqësore, në përputhje me Rregulloren e Caktimit të Gjykatësve që është miratuar

## PUNONJËSIT

- Në përputhje me Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, në Dhomat e Specializuara të Kosovës punojnë punonjës dhe gjykatës ndërkombëtarë.
- Mund të aplikojnë shtetas të 27 shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të tjera kontribuese (Kanada, Norvegji, Turqi, Shtetet e Bashkuara, Zvicër).

## DOKUMENTE THEMELORE

- Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare - ratifikuar prej Kuvendit të Kosovës më 23 prill 2014.
- Kushtetuta dhe Amendamenti Kushtetues, Neni 162: Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar – miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015.
- Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar – miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015.
- Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e Dhomave të Specializuara të Kosovës – ndryshuar për herë të fundit në qershor 2020.

## KRONOLOGJI E DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

### GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miratoi nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

### PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e DHSK-së, çka shënoi fillimin e punës së institucionit në Hagë. Dr. Donlon u riemërua Administratore në prill 2024.

### SHTATOR 2016

Dejvid Shvendiman u emërua Prokuror i Specializuar.

### DHJETOR 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e Dhomave të Specializuara dhe filloi punën në janar 2017. Gjykatëse Trendafilova u riemërua Kryetare në dhjetor 2024.

### JANAR 2017

Hyri në fuqi Marrëveshja me Shtetin Pritës, e cila përbën bazën ligjore që u mundëson Dhomave të Specializuara të Kosovës kryerjen e procedurave gjyqësore në Holandë.

### SHKURT 2017

Emërimi i nëntëmbëdhjetë gjykatësve në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

### MARS 2017

Gjykatësit miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave. Në qershor 2017, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese konfirmoi përputhshmërinë e Rregullores me Kushtetutën. Ndryshimet më të fundit hynë në fuqi në qershor 2020.

### MAJ 2018

Pietro Spera u emërua Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

### SHTATOR 2018

Xhek Smith u emërua Prokuror i Specializuar pas dorëheqjes së Dejvid Shvendimanit.

### SHKURT 2020

Prokurori i Specializuar bëri të njohur synimin e tij për nisjen e procedimeve dhe Kryetarja, Ekaterina Trendafilova caktoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për shqyrtimin e aktakuzave.

### SHTATOR/TETOR 2020

Arrestimi, transferimi dhe paraqitjet e para të Salih Mustafës, Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

### NËNTOR 2020

Arrestimi, transferimi dhe paraqitjet e para të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

### MARS 2021

Arrestimi i Pjetër Shalës në Belgjikë, pasuar nga transferimi në Hagë dhe paraqitja e tij e parë në prill 2021.

### SHTATOR/TETOR 2021

Fillon gjykimi në çështjen Prokurori i Specializuar kundër S. Mustafës dhe Prokurori i Specializuar kundër H. Gucatit dhe N. Haradinajt.

### MAJ 2022

Trupi Gjykses shpalli aktgjykimin në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

### DHJETOR 2022

Shpallet aktgjykimin në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

### SHKURT 2023

Shpallet aktgjykimin i apelit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

### SHKURT/PRILL 2023

Fillojnë gjykimet në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër P. Shalës dhe Prokurori i Specializuar kundër H.Thaçit, K.Veselit, R.Selimit dhe J.Krasniqit.

### PRILL 2023

Shpallet urdhri për zhdëmtimin e viktimave në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

### QERSHOR 2023

Kimberli Uest u emërua Prokurore e Specializuar.

### TETOR 2023

Arrestimi, transferimi dhe paraqitjet e para të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit.

### TETOR/ DHJETOR 2023

H. Gucati dhe N. Haradinaj lirohen me kusht pas modifikimit të dënimeve të tyre.

### NËNTOR/DHJETOR 2023

Arrestimi, transferimi dhe paraqitjet e para të Isni Kilajt dhe Haxhi Shalës.

### DHJETOR 2023

Shpallet aktgjykimin i apelit në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

### KORRIK 2024

Shpallet aktgjykimin në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

### SHTATOR 2024

Pas vendimit të Gjykatës Supreme të DHSK-së, Paneli i Apelit shqiptoi dënimin e ri, të zvogëluar, ndaj Salih Mustafës.

### NËNTOR 2024

Shpallet urdhri për zhdëmtimin e viktimave në çështjen Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

### DHJETOR 2024

Arrestimi, transferimi dhe paraqitjet e para të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit (akuzat lidhur me administrimin e drejtësisë).

### SHKURT 2025

Trupi Gjykses I miratoi marrëveshjet për pranimin e fajësisë midis të akuzuarve dhe ZPS-së dhe dënoi Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin me nga 2 vjet burgim, ndërsa Haxhi Shala u dënua me 3 vjet burgim.

### SHKURT 2025

Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari u liruan me kusht pas modifikimit të dënimeve të tyre.

### QERSHOR 2025

DHSK nënshkroi Marrëveshjen për Zbatimin e Dënimeve me Belgjikën.

### KORRIK 2025

Shpallet aktgjykimin i apelit në çështjen gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

### SHKURT 2026

Fillon gjykimi në çështjen gjyqësore Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.